



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 141 Akti

Nr. 74 Vendimi

Tiranë, më 06.11.2018

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Olsi Komici**  
**Suela Zhegu**  
**Xhensila Pine**

Kryesues  
Relatore  
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 05 nëntor 2018, ora 10:00, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi), candidate magjistrate, pranë Shkollës së Magjistraturës, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b, paragrafi 4 dhe 5, nenet Ç, paragrafi 1, nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016** “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Suela Zhegu, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi), kandidate magjistrate, pranë Shkollës së Magjistraturës, bazuar në paragrafin 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, do të rivlerësohet *ex officio*. I është nënshtruar procesit të rivlerësimit me kërkesë, për shkak se ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore pranë Gjykatës së Lartë, për të paktën 3 vjet, në përputhje me pikën 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe bazuar në nenin 42, pika 2 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

I është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 15 maj 2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më datë 15 maj 2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues nr. 3, më datë 15.05.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, z. Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe 3) Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit,** pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

<sup>1</sup> ILDKPKI-ja, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 29.03.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar** pasi ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi: “përshtatshmërinë për të kandiduar për magjistrat të subjektit të rivlerësimit Arnisa Këlliçi (Gorezi)”.

**Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale<sup>3</sup> për kandidaten magjistrate Arnisa Këlliçi (Gorezi) në përputhje me nenin 42, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, ku ndër të tjera, ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë, vlerësohen bazuar në:

- a) **Relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura.**
- b) **Rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.**

IKLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

**Shkolla e Magjistraturës**, ka informuar mbi “Rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*”<sup>4</sup> sipas Vendimit nr. \*\*\*, datë 21.05.2018 të Këshillit Drejtues të Shkollës Magjistraturës, ku subjekti Arnisa Këlliçi (Gorezi) rezulton fituese me 71 pikë.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

*“Nga vlerësimi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.*

*Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

<sup>2</sup> DSIK-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.07.2018, në përputhje me nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

<sup>3</sup> Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. \*\*\*, datë 02.10.2018, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>4</sup> Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.05.2018, në përputhje me nenin 42, pika 2/b të ligjit nr. 84/2016.

*Pasi u rishikua raporti i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk u gjet indice apo element që mund të ngrinte dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit”.*

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 26.10.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi), si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe me rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me hetimin e kryer nga Komisioni, duke çmuar të njihet me dosjen, për të disponuar kopje të saj, si dhe për të paraqitur ndonjë koment të mundshëm. Znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi), deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

### **QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi) ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

### **PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procedura e rivlerësimit për këtë subjekt filloi bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016 duke kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, të pavarur nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë.

Procesi i rivlerësimit për këtë subjekt, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 4/1 të ligjit nr. 84/2016, përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë; (2) kontrollin e figurës; dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Shoqëria “Ujësjetës-Kanalizime”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.

## I. VLERËSIMI I PASURISË

### Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**Hetimi administrativ i thelluar, i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**, konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

Ky hetim u përqendrua mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi), në deklaratën e pasurisë “Vetting”, shtojca 2,<sup>5</sup> në të cilën janë deklaruar këto pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme:

**1. Autoveturë, tip “Toyota Rav. 4”**, blerë më datë 14.02.2013, vlera 8.200 euro, prodhim i vitit 2006, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Blerë para fillimit të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë.

**Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga kursimet e realizuara nga pagat dhe bursa të fituara.

Lidhur me këtë deklarim janë paraqitur këto dokumente:

- Kontratë shitblerje automjeti, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.02.2013, me targë \*\*\*, me palë: blerësi: K. dhe Arnisa Këlliçi, shitësi: M.B. Çmimi i blerjes në vlerën 8.200 euro.
- Certifikatë e pronësisë së mjetit, nr. \*\*\*, datë 18.02.2013.
- Kontratë nr. \*\*\* prot., datë 06.11.2008, lidhur mes MASH-së dhe znj. Arnisa Gorezi përfaqësuar nga znj. M.G., për fondin e ekselencës për shumën 9.000 euro.
- Aktmarrëveshje nr. \*\*\* prot., datë 01.07.2010, lidhur mes MASH-së dhe znj. Arnisa Gorezi, për përfitimin e bursës së ekselencës për shumën 8.000 euro.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.06.2018,<sup>6</sup> ka konfirmuar bashkëpronësi mes Arnisa Këlliçit dhe K.K., për automjetin, autoveturë, me targë \*\*\*, duke bashkëlidhur kontratë shitblerjeje automjeti, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.02.2013, me targë \*\*\*, me palë: blerëse: K. dhe Arnisa Këlliçin, shitëse: M.B.. Çmimi sipas kontratës në shumën prej 8.200 eurosh.

<sup>5</sup> Deklarata e dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 25.01.2017.

<sup>6</sup> Shih, për më tepër shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.06.2018, bashkangjitur ndodhet dosja e automjetit, autoveturë me targë \*\*\* si dhe kontrata shitblerjeje automjeti, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.02.2013, me targë \*\*\*, me palë blerëse: K. dhe Arnisa Këlliçin e palë shitëse: M.B. Çmimi sipas kontratës në shumën 8.200 euro.

## **Analiza financiare lidhur me mundësinë financiare për blerjen e automjetit:**

Bashkëshorti K.K. ka pasur gjendje në llogarinë e tij personale, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, më datë 31.12. 2012, shumën prej 13.953 eurosh. Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Më datë 14.02.2013 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga kjo llogari shumën prej 7.500 eurosh, shumë e përdorur për blerjen e këtij automjeti.

Pavarësisht faktit se pronësia e këtij mjeti është fituar para fillimit të detyrës, si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në:

- *Vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit.*
- *Burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.*

**Komisioni konstatoi se deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje dhe me përgjigjen e ardhur nga institucionet shtetërore. Bazuar në analizën financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.**

**2. Motorçikletë, tip “Moto Guzzi”, viti i prodhimit 2001, me targa \*\*\*, blerë më datë 14.10.2009, në pronësi të shtetasit K.L.K.** Vlera totale rreth 3.000 euro, përfshin blerjen, zhdoganimin vërtetuar me dokumente, por edhe shpenzimet për transportin dhe riparimin.

**Burimi i krijimit:** Të ardhura nga kursimet prej pagave të mëparshme si pedagog pranë Universitetit “\*\*\*”.

Bashkëlidhur deklaratës në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur:

- Deklaratë personale, datë 22.01.2017, lëshuar nga z. K.K.
- Deklarata doganore për motorin, tip “Moto Guzzi”. Çmimi në shumën 1.200 euro. Shpenzime doganore në shumën 64.914 lekë.
- Deklaratë shitje për motorin, tip “Moto Guzzi”, datë 14.10.2009, nga z. N.C. për z. K.K. Çmimi në shumën 1.200 euro.
- Vërtetim noteriale, datë 14.10.2009.
- Vërtetim përkthimi, nr. \*\*\* rep., datë 27.10.2009.
- Deklarata doganore, datë 25.10.2009, për motorin, tip “Moto Guzzi”.
- Certifikatë e pronësisë së motorit, nr. \*\*\*, datë 30.10.2009. Targa \*\*\*.
- Vërtetime page (numër \*\*\*) lëshuar nga Fondacioni “\*\*\*”, datë 21.10.2016, për shumën neto 2.014.697 lekë.

## **Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.06.2018<sup>7</sup>, ka konfirmuar se shtetasja Arnisa Këlliçi (Gorezi), ka në pronësi mjetin me targa \*\*\*.

Shtetasi K.L.K. aktualisht ka në pronësi mjetet me targa \*\*\*, \*\*\* dhe ka pasur në pronësi mjetin me targa \*\*\*.

---

<sup>7</sup> Shih, në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.06.2018, ardhur nga DPSHTRR-ja e cila konfirmon se shtetasi K.L.K. aktualisht ka në pronësi mjetet me targa \*\*\*, \*\*\* dhe ka pasur në pronësi mjetin me targa \*\*\*. Shtetasi L.Q.K. ka pasur në pronësi mjetet me targa \*\*\* dhe \*\*\* (i cili figuron në statusin çregjistrim i përhershëm).

Nga ana e Komisionit u krye analiza financiare, lidhur me mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Viti	2006	2007	2008	2009	TOTAL
Të ardhura vjetore nga paga në lekë	168.034	961.330	885.333	493.812	2.508.509
Shpenzime jetese në lekë	160.714	160.714	160.714	160.714	642.857
<b>Diferenca e mundshme për kursim në lekë</b>	<b>7.320</b>	<b>800.616</b>	<b>724.619</b>	<b>333.098</b>	<b>1.865.652</b>

- ✓ **Komisioni, nga hetimi i kryer dhe analiza financiare konstaton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për blerjen e motorçikletës.**

**3. Llogari bankare për pagat në “Credins Bank”.** Gjendja në datën e dorëzimit, në vlerën 22.630 lekë. Zotërimi: 100 %.

**Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë.

Rezulton se subjekti ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 21.01.2017, për llogari në emër të znj. Arnisa Gorezi, me gjendje më datë 21.07.2017, në vlerën 27.630,17 lekë.
- “Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.08.2017, konfirmon gjendje në llogarinë e pagës së znj. Arnisa Këllicit, më datë 25.01.2017, me vlerë 27.630 lekë.

**ILDKPKI-ja**, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur se: ” *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga “Credins Bank” është si rezultat i marrjes së informacionit në dy data të ndryshme*”.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

“Credins Bank<sup>8</sup>” me shkresën dërguar, më datë 31.08.2018, ka konfirmuar se, më datë 25.01.2017, në llogarinë e subjektit gjendja është në shumën prej 22. 630 lekësh.

**Komisioni, nga hetimi i kryer konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.**

**4. Llogari bankare pranë “Alpha Bank”<sup>9</sup>, për pagat nga mësimdhënia.** Gjendja në datën e dorëzimit është në vlerën 924,34 euro. Zotërimi: 100 %.

**Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat për mësimdhënie pranë Universitetit “\*\*\*”.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës:

<sup>8</sup> Shih, për më tepër në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.06.2018, drejtuar 27 bankave të nivelit të dytë dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2018, nga “Credins Bank”.

<sup>9</sup> Shih, në dosje shkresën e ardhur nga “Alpha Bank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 21.06.2018, konfirmon llogari në emër të znj. Arnisa Gorezi.

- Nxjerrje llogarie nga “Alpha Bank”, datë 23.01.2017, për llogari të znj. Arnisa Gorezi, me gjendje më datë 23.1.2017, në vlerën 924,34 euro.
- “Alpha Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.07.2017, konfirmon gjendjen në llogarinë e pagës në emër të znj. Arnisa Gorezi, më datë 25.01.2017, me vlerë 924,34 euro.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

“Alpha Bank” me shkresën nr. \*\*\*, datë 21.06.2018, ka konfirmuar llogarinë në emër të znj. Arnisa Gorezi, me gjendje më datë 23.01.2017, në vlerën prej 924,34 eurosh.

- ✓ *Komisioni ka konstatuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me të dhënat e marra nga “Alpha Bank”.*

**5. Llogari bankare për pagat në emër të bashkëshortit K.K. në “Credins Bank”<sup>10</sup>.**

**Gjendje në datën e dorëzimit në vlerën 27.743 lekë. Zotërimi: 100 %.**

**Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat si pedagog i brendshëm në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka paraqitur:

- Nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 19.01.2017, në emër të z. K.K., me gjendje në vlerën 27.743 lekë.
- “Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.08.2017, konfirmon gjendje në llogarinë e pagës së z. K.K., në datë 25.01.2017, me vlerë 27.743 lekë.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

“Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 08.08.2017, dhe nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2018, konfirmon gjendjen e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

- ✓ *Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me të dhënat e marra nga “Credins Bank”.*

**6. Llogari në euro dhe lekë në Bankën Kombëtare Tregtare<sup>11</sup>.** Gjendja në datën e deklarimit në vlerën 8.666 euro. Zotërimi: 100 %.

**Burimi i krijimit:** Dëmshpërblim për zgjidhje të pajustificuar të marrëdhënies së punës nëpërmjet vendimit gjyqësor, nr. \*\*\*, datë 24.12.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka paraqitur:

- Nxjerrje llogarie nga “BKT”-ja, datë 19.01.2017, me gjendje më datë 28.12.2016, në vlerën 8.666 euro dhe 0 (zero) lekë.
- Nxjerrje llogarie nga “BKT”, datë 24.01.2017, për veprimet në llogari për periudhën 01.02.2014 - 21.12.2016 për llogarinë në euro dhe në lekë.

<sup>10</sup> Shih, për më tepër në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.06.2018, drejtuar 27 bankave të nivelit të dytë dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2018, nga “Credins Bank”.

<sup>11</sup> Shih, në dosje shkresën me nr. nr. \*\*\*, datë 18.06.2018, konfirmon gjendje në llogarinë e z. K.K., në datë 25.01.2017, me vlerë 8.666 euro dhe 0 (zero) lekë.



- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. \*\*\*, datë 24.12.2013, me palë paditëse: z. K.K. dhe të paditur: “\*\*\*” sh.p.k., me objekt: dëmshpërblim për zgjidhje të pajustificuar të kontratës.
- Deklaratë personale nga z. K.K., datë 22.01.2017, në lidhje me pagat e marra nga Universiteti \*\*\*, bashkëlidhur: nxjerrje llogarie për z. K.K. nga “Credins Bank”, datë 18.10.2016, për kreditimin në llogari të pagës nga Universiteti \*\*\*, në vlerën prej 70.197 eurosh.
- “BKT”-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.07.2017, konfirmon gjendje në llogarinë e z. K.K., më datë 25.01.2017, me vlerë 8.666 euro dhe 0 (zero) lekë.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

“BKT”-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 18.06.2018, ka konfirmuar gjendje në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, z. K.K., më datë 25.01.2017, me vlerën prej 8.666 eurosh.

- ✓ *Komisioni nga hetimi i kryer konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me të dhënat e marra nga “BKT”-ja.*

**7. Llogari kursimi në euro në “Fibank” (First Investimet Bank of Albania)<sup>12</sup>. Gjendja në datën e deklarimit, në vlerën 541 euro. Zotërimi: 100 %. Llogaria është e lidhur me llogaritë e kartës së kreditit për efekt shlyerje. Gjendje në kartën e kreditit, në vlerën 4.49 euro.**

**Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga “Fibank”, datë 19.01.2017, me gjendje llogari, më datë 31.12.2016, në vlerën 541,11 euro dhe kartë krediti me vlerë 4.49 euro.
- Nxjerrje llogarie nga “Fibank”, datë 18.10.2016, për veprimet në llogarinë e kursimit dhe kartën e kreditit për periudhën 4.01.2014 - 31.12.2014.
- “Fibank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 14.07.2017, konfirmon gjendje në emër të z. K. K.;
  - Llogari kursimi, me vlerë 541,11 euro.
  - Llogari kartë krediti, me vlerë 4.49 euro.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

“Fibank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 25.06.2018, konfirmon gjendje në emër të z. K.K.;

- Llogari kursimi, me vlerë 541,11 euro.
- Llogari kartë krediti, me vlerë 4.49 euro.

- ✓ *Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje dhe me të dhënat e marra nga “Fibank”.*

**8. Llogari bankare për pagat nga mësimdhënia, në “Alpha Bank”<sup>13</sup>. Gjendja në datën e dorëzimit në vlerën prej 924,34 eurosh. Zotërimi: 100 %.**

<sup>12</sup> Shih, shkresën me nr. \*\*\* prot, datë 25.06.2018, ardhur nga “Fibank”, e cila konfirmon gjendjen në emër të z. K.K.

<sup>13</sup> Shih, shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 21.06.2018, ardhur nga “Alpha Bank”, konfirmon gjendje në llogarinë e pagës, në emër të znj. Arnisa Gorezi, më datë 25.1.2017 me vlerë 924,34 euro.

**Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat për mësimdhënie pranë Universitetit “\*\*\*”.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga “Alpha Bank”, datë 23.01.2017, për llogari në emër të znj. Arnisa Gorezi, me gjendje në datë 23.1.2017, në vlerën 924,34 euro.
- “Alpha Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.07.2017, konfirmon gjendje në llogarinë e pagës në emër të znj. Arnisa Gorezi, më datë 25.01.2017, me vlerë 924,34 euro.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 21.06.2018, ardhur nga “Alpha Bank” konfirmon gjendjen në llogarinë e pagës në emër të znj. Arnisa Gorezi, më datë 25.01.2017, me vlerë 924,34 euro.

- ✓ *Komisioni nga hetimi i kryer konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje dhe me të dhënat e marra nga “Alpha Bank”.*

**9.** Huadhënie në shumën prej 60.000 lekë gjatë periudhës së deklaramit. Kjo hua është shlyer tërësisht në “Raiffeisen Bank”, më datë 07.10.2014. Vërtetuar me deklaratën e datës 17.10.2014.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Deklaratë e datës 17.10.2014 për shlyerje detyrimi, në shumën 60.000 lekë, shoqëruar me nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 23.01.2017, për kreditimin në llogari nga znj. E.A., të shumës 60.000 lekë.

**Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se:**

Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 19.06.2018, ardhur nga “Raiffeisen Bank” konfirmon veprimin e kryer më datë 23.01.2017.

- ✓ *Komisioni ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar në dosje.*

**10. Apartament në përdorim me bashkëshortin, me sip. 145 m<sup>2</sup>, në pronësi të babait të bashkëshortit, me adresë: Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Viti i krijimit 1997.**

**Burimi i krijimit:**

Babai i bashkëshortit, z. L.Q.K. (vjeherri i subjektit), është një nga pronarët e truallit ku është ndërtuar pallati, me vendim të KKK Pronave Tiranë dhe më pas me kontratë ndërtimi ka përfituar sipërfaqen takuese në këtë ndërtesë, në këmbim të truallit. Ky apartament nuk ka çmim blerje, pasi është përfituar në këmbim të truallit. Vlera nuk është specifikuar në kartelën e pasurisë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Vendim nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nr. \*\*\*, datë 20.03.1996, për njohjen si ish-pronar të z. M.K. (trashëgimtarët e tij ligjorë).

- Plan vendosja e pronës.
- Kontratë ndërtimi për ndërtesë pallati, datë 07.02.1997, lidhur ndërmjet z. L.K. dhe firmës ndërtuese “\*\*\*”.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, datë 9.5.2012, për pasurinë me nr. \*\*\*, e llojit apartament, me sip. 145 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. L.K.
- Kartela e pasurisë së apartamentit.

### **Komisioni nga hetimi administrativ ka rezultuar se:**

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë<sup>14</sup> ka konfirmuar pasurinë apartament sipas dokumentacionit të administruar në dosje në pronësi të z. L.K., vjehri i subjektit.

### **Mënyra e fitimit të pronësisë.**

Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka bashkëlidhur në deklaratën “Vetting” dokumentacionin me të cilin është fituar apartamenti në pronësi të vjehrit.

ZVRPP-ja Tiranë, me përgjigjen e ardhur ka konfirmuar lidhur me këtë pasuri se, është e regjistruar në emër të shtetasve si më poshtë :

- Znj. M.Z.G., në bashkëpronësi me znj. P.H.G., pasurinë me sipërfaqe 88,3 m<sup>2</sup>, në ZK \*\*\*.
- Znj. L.L.K., ka të regjistruar truall, me sip. 280 m<sup>2</sup> + ndërtesë, me sip. prej 79 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me të tjerë, z. T.L.S. dhe znj. Z.L.S.  
Ndërsa për sa i përket shtetasve :
- Znj. Arnisa M. Këlliç, z. K.L.K. dhe z. L.Q.K., nuk figurojnë pasuri.

Në përgjigjet e pyetësorit nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar se :

Më datën 08.03.2018, babai i bashkëshortit, i ndjeri L.Q.K., pronar i kësaj pasurie ka ndërruar jetë, por ende nuk është çelur testamenti i tij nga trashëgimtarët ligjor.

Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së, certifikatën për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, datë 09.05.2012, për pasurinë me nr. \*\*\*, e llojit apartament, me sip.145 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. L. K., vjehrit tuaj. Për rrjedhojë, nga ana e subjektit të rivlerësimit është dokumentuar apartamenti në pronësi të vjehrit dhe mënyra e fitimit të tij.

- ✓ ***Komisioni nga hetimi i kryer ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar në dosje dhe përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.***

### **Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë**

Trupi gjykues, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë, nuk ka konstatuar elementë të cilët mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi). Deklarimet janë të mjaftueshme, pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

<sup>14</sup> Shih, për më tepër shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 09.07.2018, ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, e cila konfirmon se subjekti dhe b/shorti nuk kanë pasuri të paluajtshme të regjistruar pranë kësaj zyre.

## **II. KONTROLLI I FIGURËS**

### **Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi).

### **Konkluzioni për vlerësimin e kontrollit të figurës**

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për sa i përket elementit të pastërtisë së figurës, për subjektin e rivlerësimit u konstatua, **përshtatshmëria e kandidatës magjistratë , znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi).**

## **III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Për sa i përket burimeve për vlerësimin e aftësive profesionale, për ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, pika 2, neni 42, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar se vlerësohen bazuar në (a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura, dhe (b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

**Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD)**, ka përcjellë “Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e :

- 1- Formularit të vetëdeklarimit dhe 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe aktet që shoqërojnë këtë formular.
- 2- 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- 3- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur, IKLD-ja ka konstatuar saktësinë e formularit të vetëdeklarimit dhe të akteve bashkëlidhur këtij formulari.

IKLD-ja, ka evidentuar faktin se, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatë të Lartë të paktën 3 vjet, për periudhën kohore duke filluar nga 3 shkurt 2014 - 7 shkurt 2017.

Gjithashtu, ka evidentuar faktin se, ndihmësja ligjore ka depozituar pranë KLD-së, më datë 26.01.2017, formularin e vetëvlerësimit profesional dhe aktet shoqëruese, në kohën që ushtronte detyrën si ndihmëse ligjore dhe pas përfundimit të kësaj detyre, më datë 08.02.2017, ka depozituar pranë KLD-së, kërkesën për vazhdimin e procedurës së rivlerësimit.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është bazuar, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit, si:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;

- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

## **1. Aftësitë profesionale**

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të analizuar konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën civile, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit - si ndihmëse ligjore në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Nga pikëpamja formale, relacionet e hartuara nga ndihmësja ligjore, znj. Arnisa Këlliçi, përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në nenin 25 të "Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë". Në drejtim të shkrimit ligjor, dokumentet ligjorë të vëzhguar janë të shkruara qartë dhe në mënyrë të kuptueshme, me strukturë të mirëorganizuar. Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të numërtuar. Mendimi i ndihmësit ligjor rezulton të ketë qenë i njëjtë me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

## **2. Aftësitë organizative**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi, në funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, ka relatuar një numër të konsiderueshëm çështjesh. Nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë rezulton të ketë hartuar 376 akte të relatimit të çështjeve, me natyrë civile.

## **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi, i ka kushtuar rëndësi të veçantë formimit akademik, pasi ka përfunduar studimet e larta me rezultate maksimale, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2006 i është akorduar "Medalja e Artë".

Pasi ka marrë titullin "Master në Drejtësi", i është akorduar diploma "Ekselencia shqiptare" duke fituar bursën e Fondit të Ekselencës të MASH-së në vitin 2008 për vazhdimin e studimeve të doktoraturës, në Hungari. Këto studime i ka përfunduar, duke marrë gradën shkencore "Doktor i Shkencave Juridike".

## **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara, gjuha e përdorur në përputhje me etikën gjyqësore: e qartë, e plotë dhe e saktë. Nuk janë konstatuar vonesa në relatimin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**Shkolla e Magjistraturës**<sup>15</sup> ka dërguar pranë Komisionit, rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 42/2 dhe 68/2 të ligjit nr. 84/2016 si dhe pika 4, neni 165 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", nga ku ka rezultuar se subjekti Arnisa Këlliçi (Gorezi) është kualifikuar fituese (me 71 pikë).

### **Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale**

---

<sup>15</sup> Shih, në dosje shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 23.05.2018, ardhur nga Shkolla e Magjistraturës për rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se subjekti Arnisa Këlliçi (Gorezi), është kualifikuar fituese, klasifikuar e dyta (me 71 pikë) nga 47 pjesëmarrës.

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk gjeta asnjë indice apo element që cenon figurën e subjektit të rivlerësimi, znj. Anisa Këlliçi (Gorezi), sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 dhe propozoj për subjektin e rivlerësimit: “**I aftë**”.

### **SEANCA DËGJIMORE**

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, më datë 31.10.2018, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Marie Tuma, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Anisa Këlliçi (Gorezi), në seancë dëgjimore në datën 5 nëntor 2018, ora 10:00, në ambientet e godinës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Këlliçi (Gorezi), është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, më datë 31.10.2018. Subjekti ka komunikuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 05.11.2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, dhe deklaroi se ishte dakord me gjithë hapat proceduralë të ndjekur nga trupi gjykues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anisa Këlliçi (Gorezi), deklaroi se është dakord me rezultatet e hetimit, duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

### **IV. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, konstaton se:

- ✓ subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ✓ subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- ✓ subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale; në përputhje me nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 58, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenit 165, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusit e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Arnisa Këlliçi (Gorezi), për kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit.
2. Vazhdimin e programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës për kandidaten magjistrate.
3. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 06.11.2018.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**

**Kryesues**

**Suela ZHEGU**

**Relatore**

**Xhensila PINE**

**Anëtare**

Sekretare gjyqësore

Olsida Goxhaj